

UDHËZIM
Nr. 28, datë 24.2.2023

**MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME, MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË, PËR GARANCINË FINANCIARE NË
PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË VIZAVE PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse në procesin e përcaktimit të garancisë financiare, në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

I. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË PROCEDURËN E PËRCAKTIMIT TË GARANCISË FINANCIARE NË VLERËSIMIN E VIZAVE PËR TË HUAJT

1. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, që bashkëpunojnë në procesin e përcaktimit të garancisë financiare në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) Në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë “MEPJ”) – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë “DÇK”) dhe Postet Konsullore (më poshtë “PDK”) të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit;

b) Në Ministrinë e Brendshme (më poshtë “MB”) – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);

c) Ministria e Financave dhe Ekonomisë (më poshtë “MFE”).

2. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, secili nga autoritetet e sipërpërmendura bashkëvepron me institucionet e tjera për çështjet e trajtimit të aplikimeve për viza, për hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e të huajve, sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim.

II. GARANCIA FINANCIARE

1. Garancia financiare depozitohet në llogarinë bankare të aplikantit nga vetë i huaji që aplikon për vizë, nga garanti i të huajit, ose nga ftuesi i tij në Republikën e Shqipërisë, duke dokumentuar, gjithashtu, nëpërmjet vërtetimit nga banka që nuk janë kryer derdhje të pajustificuara, në këtë llogari bankare, të paktën për 12 muajt e fundit.

2. Shuma e garancisë financiare që duhet të paraqitet në dokumentacionin për pajisjen me vizë nga i huaji, për rastet e përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të jetë të paktën 5000 (pesë mijë) lekë për ditë qëndrimi të kërkuar në vizë për personat mbi 18 vjeç dhe 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë për shtetasit nën 18 vjeç.

3. Garancia financiare për mbulimin e shpenzimeve të jetesës apo pasojat e një dëmi që mund të shkaktohet nga një veprim ose mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për periudhën e vlefshmërisë së vizës, përcaktohet rast pas rasti, për vizat e tipit D, të specifikuara më poshtë:

a) viza për të trajnuarin pa pagesë;

b) viza për persona të vetëpunësuar;

- c) viza për punonjës lëvizës digjital;
- d) viza për investitorë;
- e) viza për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi;
- f) viza për pensionistë;

4. Në dokumentin e garancisë financiare, duhet të jetë e përcaktuar shuma e bazuar në legjislacion për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, si dhe shuma për pasojat e një dëmi që mund të shkaktohet nga një veprim ose mosveprim i të huajit, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, e depozituar në të njëjtën llogari bankare, e cila nuk mund të tërhiqet nga i huaji ose garantuesi i tij në Republikën e Shqipërisë, deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së vizës.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Bledar Çuçi

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Olta Xhaçka

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj